



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Lubjanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. Nr. 61/23

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga Kimete Gashi - Kryetare, Agon Ramadani - Anëtar, Vedat Poterqoi - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) "NSHT Victory Com"- Prishtinë lidhur me aktivitetin e prokurimit "Trajtimi i rrugëve me zhavor ne fshatrat e Komunës së Prishtinës" me nr. të prokurimit: 616-22-11624-511, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës, me 02.05.2023 mori:

V E N D I M

1. Aprovohet, ankesa e operatorit ekonomik OE "NSHT Victory Com"- Prishtinë e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit, lidhur me aktivitetin e "Trajtimi i rrugëve me zhavor ne fshatrat e Komunës së Prishtinës" me nr. të prokurimit: 616-22-11624-511, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës.

2. Anullohet, Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës për këtë aktivitetin të prokurimit dhe lënda kthehet në rivlerësim.

3. Në afat prej 10 ditësh, AK (me të dhëna si në paragrafin paraprak të këtij vendimi), duhet ta informoj me OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit (precizuar me numër dhe datë, po ashtu si në paragrafët paraprak të këtij vendimi), në të kundërtën OSHP ka të drejtë të ndërmarr masa ndaj AK për mos respektim të vendimit, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (versioni i amandamentuar);

4. Meqenëse ankesa e OE "NSHT Victory Com"- Prishtinë, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i depozitës së paguar me rastin e parashtrimit të ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që

konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 24.10.2022, Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar “Trajtimi i rrugëve me zhavor ne fshatrat e Komunës së Prishtinës” me nr. të prokurimit: 616-22-11624-511.

Me datën 19. 01. 2023, AK ka publikuar njoftimin për dhënie të kontratës ku ka shpërblyer me kontratë për Llot 1 “Integral” shpk dhe Llot 2 “Milinium Constructin” shpk.

Me datën 23. 01. 2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim OE “NSHT Victory Com & Murseli & Marisa shpk”- Prishtinë, të cilën kërkesë me datën 26. 01. 2023 e ka refuzuar AK.

Për shkak të arsyeve dhe rrethanave të përshkruara si më sipër me 03.02.2023, OE “NSHT Victory Com & Murseli & Marisa shpk”- Prishtinë përmes platformës elektronike (e-prokurimi) nga cilësia e palës së pakënaqur ka ushtruar ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit (Protokolli Nr. 61/23)

- Administrimi dhe vlerësimi i provave-

Nisur nga faktet e cituara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 lidhur me nenin 114, të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 21. 02. 2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- Të aprovohet ankesa;
- Të anulohet vendimi i AK-së për dhënie të kontratës

Sqarim hyrës: Autoriteti kontraktues Komuna e Prishtinës, ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës punë, kriteri i dhënies së kontratës tenderi i përgjegjshëm me Çmimi më të ulët, vlera e madhe, vlera e parashikuar e kontratës 1.000.000,00euro. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë për lot 2 përkatësisht kundër propozimit për dhënie të kontratës.

Duke u bazuar në B58 Njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 19.01.2023, është konstatuar si në vijim: AK- Komuna e Prishtinës, shpërblen me kontratë për Lot II operatorin ekonomik “MILENIUM KONSTRUCTION ” SH.P.K , me çmimin të poentuar prej 7.20 euro.

Përgjigje në pretendimet ankimore (Neni 113 LPP) N.SH.T “VIKTORY COM” -Gjakovë

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore, operatori ekonomik ankues N.SH.T "VIKTORY COM"-Gjakovë, më tej si parashtuesi i ankesës, pas qasjes në dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë pretendon se operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë i mungon Inxhinieri i Gjeodezis pasi që ka paraqitur një marrëveshje me një kompani e cila është NSH Gjeodeti për punë gjeodezike kurse licencën e ka paraqitur në emër të personit fizik me tej OE ankues shton se në dosjen e tenderit mungon edhe diploma e gjeodetit gjithsesi ky kriter është që e diskualifikon këtë OE sepse në kërkesë të dosjes së tenderit ka qene që marrëveshja të behet në emër të aktivitetit të prokurimit kurse OE nuk e ka në emër të aktivitetit të prokurimit por e ka të vitit 2019 pra kjo marrëveshje është jo valide dhe në kundërshtim me DT.

Përgjigje në pretendimet ankimore (Neni 113 LPP) N.SH.T "VIKTORY COM" -Gjakovë

Eksperti teknik shqyrtuese sqaron se AK të pika 9.1 & 9.2 e dosjes së tenderit ka kërkuar:

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:

Një inxh.ndërt. (inxhinier ose bachelor) drejtimi gjeodezisë - 3 vite përvojë pune pas diplomimit për llot I dhe llot II

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

CV-a, Diploma, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt. Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt.

Eksperti teknik shqyrtuese sqaron se për këtë inxhinier, OE i rekomanduar me kontratë ka bashkangjitur MARRVESHJE KONTRAKTUALE BIZNESORE të përpiluar në Prishtinë e me datën 12.10.2019 në mes të palëve kontraktuese:

- NSH "Gjeodeti" me seli në Mitrovicë; me numër të regjistrimit të biznesit 8103611776 përfaqësuar nga drejtori z. Nehat Sahiti, në tekstin e mëtejme Shërbyesi, dhe
- "Milenium Konstruktion" SH.P.K. me seli në Prishtinë dhe numër të regjistrimit të biznesit 810795403, e përfaqësuar nga Drejtori z. Misim Aliu, në tekstin e mëtejme Shfrytëzuesi

Në pikën 2 të kësaj marrëveshje thuhet: shërbyesi obligohet që të realizoj të gjitha matjet gjeodezike për kompaninë "Milenium Konstruktion" SH.P.K. në përputhje me kushtet e kërkuara në dosjen e tenderëve publik të publikuar nga Ministritë relevante, apo Komunitat e Republikës së Kosovës.

Ndërsa në pikën 6. të kësaj marrëveshje thuhet: Kjo marrëveshje kontraktuale për shërbime gjeodezike është valide në momentin e nënshkrimit të saj, dhe nuk ka afat të skadimit. Kjo marrëveshje mund të shkëputet vetëm me njoftim paraprak nga të dyja palët e kësaj marrëveshjeje.

Eksperti teknik shqyrtues sqaron se pretendimi i OE ankues se “OE i rekomanduar për kontratë i mungon Inxhinieri i Gjeodezis pasi që ka paraqitur një marrëveshje me një kompani e cila është **NSH “Gjeodeti”** për punë gjeodezike kurse licencën e ka paraqitur në emër të personit fizik”, nuk qëndron se kompania **NSH “Gjeodeti”** për drejtor ka z. Nehat Sahit i cili është i diplomuar në gjeodezi sipas Vendimit të MASHT-së- Këshilli Shtetëror për Njohje me ref. Nr. 6-3449 të datës 05/09/2018 të cili i njihet Shkolla e Lartë **“Inžinjer Geodezije”**, studime tre vjeçare , e fituar në **“Sveučilište u Zagrebu” Kroaci** dhe licenca është në emër të z. **Nehat Sahit** me numër **08** : data e dhënies së Licencës - **27.03.2024** , dhe afati i skadencës të Licencës -**25.03.2024**.

Sa i përket pretendimit se OE i propozuar për kontratë se Inxhinierit të gjeodezis i mungon dhe diploma e gjeodetit. Eksperti shqyrtues sqaron se AK-ja në këtë rast duhet të veproj në përputhje me nenin 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë dhe nenin 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve të LPP-së, pasi që OE i propozuar për kontratë për inxhinierin e gjeodezisë e ka dorëzuar VENDIMIN nga MASHT-të- Këshilli Shtetëror për Njohje me të cilin i njihet diploma për përfundimin e Shkollës së Lartë **“Inžinjer Geodezije”**, studime tre vjeçare.

Prandaj bazuar ne këto që u thanë me lart rezulton se ky pretendim i OE është pjesërisht i bazuar

Sa i përket pretendimit se OE ankues se i propozuar për kontratë **MARRVESHJEN KONTRAKTUALE BIZNESORE** për gjeodetin e ka te vitit 2019 dhe nuk është valide Eksperti teknik sqaron se ne piken 6 te kësaj marrëveshje thuhet: Kjo marrëveshje kontraktuale për shërbime gjeodezike është valide në momentin e nënshkrimit të saj, dhe nuk ka afat të skadimit. Kjo marrëveshje mund të shkëputet vetëm me njoftim paraprak nga të dyja palët e kësaj marrëveshjeje.

Prandaj bazuar ne këto që u thanë me lart rezulton se ky pretendim i OE është i pa bazuar

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore, operatori ekonomik ankues N.SH.T **“VIKTORY COM”**-Gjakovë, më tej si parashtruesi i ankesës, pas qasjes ne dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë pretendon se operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë se Punët e Betonit nuk mund te behën me 10.00 euro siç e ka cekur ne pozicionin 4.2 ky OE, pasi qe OE i rekomanduar për kontratë për pozicionin 4.1 të betonit ka paraqitur çmim 90.00 euro kurse ky produkt është shumë me i thjesht dhe ka çmim shume me të ulet se produkti i betonit c25/30 pra ky OE është i vetëdijshëm për çmimet e tregut por ka qitur në lajthitje AK me këto çmime

Eksperti teknik shqyrtues sqaron se AK-ja për këtë tender e ka aplikuar **ÇMIMIN E PESHUAR PËR NJËSI** ndërsa pozicionin 4. Punët e betonit te cilën e përbejnë pesë nënë pozicione përkatësisht nënë pozicionin 4.2 Furnizimi, transporti kallepimi vendosja kompaktimi i betonit të klasit C25/30 për themele, mure dhe lëshesë betonarme. E ka peshuar me pikë për njësi më shumë nga pozicioni 4. Punët e betonit te cilin e peshon gjithsej me 10.30 pikë, ndërsa nënë pozicionin 4.2 e peshon me 5.00 pikë pra nëse e shndërrojmë në përqindje të peshimit për pozicionin 4 . Punët e betonit, vetëm nënë pozicioni 4.2 ka 48.54% të peshës së këtij pozicioni ndërsa katër

nënë pozicionet tjera i ka peshuar me 51,46% , AK-ja këtë nënë pozicion e ka peshuar me vlerë te madhe dhe i cili pozicion do të përdoret më së shumti gjatë realizimit të kësaj kontrate për aktivitetin Punët e Betonit

Eksperti teknik shqyrtues sqaron se në çdo rast kur tenderët duken jo normalisht të ulët, Autoriteti Kontraktues do të veprojë në përputhje me nenin 61 të LPP-së dhe nenin 41 të Rregullores për Prokurimin Publik ne paragrafin 41.6 thuhet: Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit ku aplikohet çmimi i peshuar për njësi) duket të jetë jo normalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkoj me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin ose pozicionin e tenderit që duket të jetë jo-normalisht i ultë sipas paragrafit 41.3 ose 41.4 të kësaj rregullore, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshin një shpjegim për çmimin e ultë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja "Shkresa standarde për tenderët jo-normalisht të ulët".

Si dhe paragrafi 41.8 në të cilën thuhet: Gjatë përcaktimit se nëse një tender është jo normalisht i ulët, Autoriteti kontraktues duhet të merr në konsideratë:

a. ekonominë e procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit;

Siç po shihet nga ky Rekapitullim në tabelën e dhënë më lartë, së paku duhen 14 aktivitete të kryhen për vendosjen në vepër të 1 m³ beton të klasës C25/30. Vetëm sasia cementit e cila duhet të përdoret për 1.0 m³ beton të gatshim e që është 6 thasë/ 50 kg x 7.5 = 45 euro , e tejkalon për së paku katër herë çmimin e dhënë me ofertë për këtë pozicion prej 10 eurove.

Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se pretendim i OE ankues është i bazuar

Me raportin e ekspertizës me datën 27 shkurt 2023, ka deklaruar se pajtohet OE ankues.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesës, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor.

Paneli shqyrtues lidhur me pretendimin ankimor sa i përket gjeodetit të licensuar e klasifikon si të pabazuar për shkak se OE i cili ka lidhur marrëveshjen e bashkëpunimit me NSH Gjeodeti drejtor i se cilës është z. Nehat Sahiti dhe është i licensuar.

Lidhur me pretendimin tjetër sa i përket zbatimit të nenit 61 të LPP për çmime jo-normalisht të ulëta, PSH e klasifikon të bazuar dhe AK duhet të veprojë në përputhje me nenin e lartcekur.

- Përfundim -

Duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, sipas dispozitave të neneve 104 dhe 105, të Ligjit të cituar dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, natyrës dhe

qëllimit të pretendimeve ankimore, autorizimeve, veprimeve dhe synimeve të AK, Paneli Shqyrtues konstaton se: paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, vlerëson se ankesa është e bazuar.

Nisur nga shpjegimet si më sipër Paneli konsideron se AK nuk ka vepruar në harmoni me dispozitat e cituara si më sipër të LPP me saktësisht paneli shqyrtues vlerëson se gjatë zhvillimit të kësaj procedure të prokurimit, AK nuk ka vepruar në harmoni me nenin 59 të LPP-së pasi që nuk ka bërë vlerësimin dhe ekzaminimin e tenderëve konform kësaj dispozite ligjore.

Gjithashtu, paneli shqyrtues sqaron se AK-ja për këtë tender e ka aplikuar çmimin e peshuar për njësi ndërsa pozicionin 4. Punët e betonit te cilën e përbejnë pesë nënë pozicione përkatësisht nënë pozicionin 4.2 Furnizimi, transporti kallepimi vendosja kompaktimi i betonit të klasit C25/30 për themele, mure dhe lëshesë betonarme, e ka peshuar me pikë për njësi më shumë nga pozicioni 4. Punët e betonit te cilin e peshon gjithsej me 10.30 pikë, ndërsa nënë pozicionin 4.2 e peshon me 5.00 pikë pra nëse e shndërrojmë në përqindje të peshimit për pozicionin 4 . Punët e betonit, vetëm nënë pozicioni 4.2 ka 48.54% të peshës së këtij pozicioni ndërsa katër nënë pozicionet tjera i ka peshuar me 51,46%, AK-ja këtë nënë pozicion e ka peshuar me vlerë te madhe dhe i cili pozicion do të përdoret më së shumti gjatë realizimit të kësaj kontrate për aktivitetin Punët e Betonit, Andaj, duke pasur parasysh këtë sqarim, paneli shqyrtues sqaron se në çdo rast kur tenderët duken jo normalisht të ulët, Autoriteti Kontraktues duhet te veprojë në përputhje me nenin 61 të LPP-së dhe nenin 41 të Rregullores për Prokurimin Publik ne paragrafin 41.6 thuhet: Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit ku aplikohet çmimi i peshuar për njësi) duket të jetë jo normalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkoj me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin ose pozicionin e tenderit që duket të jetë jo-normalisht i ultë sipas paragrafit 41.3 ose 41.4 të kësaj rregullore, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshin një shpjegim për çmimin e ultë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja "Shkresa standarde për tenderët jo-normalisht të ulët".

Ndonëse mendimi i ekspertit nuk është detyrues, Paneli sipas mendimit të pavarur të tij e ka mbështetur raportin e ekspertit në rastin konkret, nisur nga parimi se vlera provuese e tij jepet gjithnjë me raport me vlerësimin, krahasimin dhe administrimin e të gjitha provave tjera dhe natyrën e një çështje në rastin konkret.

Paneli shqyrtues konsideron se vendimi i marrur në këtë çështje është i bazuar në administrimin e të gjitha provave, në dispozicion të kësaj lënde dhe se në marrjen e vendimeve gjithmonë ka parasysh nenin 1 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese. Paneli Shqyrtues nisat gjithnjë nga fakti se autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit

publik, mirëpo mbetet në detyrimin e tyre eksplisit respektimi i ligjshmërisë në procesin e prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetare e Panelit Shqyrtues
Kimete Gashi



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë që ti drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë me padi, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimin të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet;

1x1 AK KK Prishtine

1x1 Ankuesit

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së